

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS si kontestimore e përbërë nga kolegji gjyqësorë: Faton Ademi kryetar dhe anëtarëve porotë: Mujë Peci dhe Kimete Fejza në çëshjen juridike të propozuesit: F.Th. nga Mitrovica të cilin e përfaqëson Av. J.B. dhe propozuesës: M.Th. e vajzërisë A. të cilën e përfaqëson Av. U.G. për shkak të zgjidhjes së martesës, pas mbajtjes së seancës kryesore, me dt.13.04.2017 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- Martesa në mes të propozuesve: F.Th. nga Mitrovica i lindur me ... nga babai Sh. dhe nëna M. dhe M.Th. e vajzërisë A. nga Mitrovica lindur me ... nga babai N. nëna N. e lidhur me dt. ... pranë zyrës së gjendjes civile në Mitrovicë e evidentuar me numër rend. ... dhe nr. ref. ... RM/..., zgjidhet në bazë të marrëveshjes së përbashkët konform nenit 68 paragrafi 2 dhe 69 paragrafi 2 te Ligjit mbi Familjen i Kosovës.
- Fëmijët e mitur: E .Th. e lindur me ... në Mitrovicë dhe S. Th. e lindur me ... në Mitrovicë i **BESOHEN** në përkujdesje, edukim dhe ushqim propozuesit F. Th si babë.
- Kontaktet personale të propozueses me fëmijët e tyre caktohen dy herë në muaj, të Mërkurën e parë dhe të tretë të çdo muaji në lokalet e Qendrës për punë Sociale në Mitrovicë dhe atë nga ora 11:00 deri në ora 14:00.
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Procedur a e shkurorëzimit në gjykatë është iniciuar me anë të padisë nga paditësi F. Th., mirëpo në seancën e mbajtur i autorizuari i palës paditëse ka deklaruar se nuk e kundërshton padinë e paditësit, prandaj janë përmbushur kushtet që të bëhet shkurorëzimi me propozim të përbashkët.

Në seancë i autorizuari i propozueses deklaroi se në tërësi mbetet pranë padisë, ndërsa sa i përket kontakteve personale të propozueses me fëmijët ka deklaruar se dëshiron që të precizohen disa çështje të cilat kanë të bëjnë rreth termineve dhe ditëve kur pala e paditur sepse edhe gjer më tani e njëjta ka pasur kontakte me fëmijët, mirëpo nuk është respektuar orari p.sh. ajo i ka marrë fëmijët për tri ditë ndërsa i ka kthyer pas tri orëve dhe tërë kjo po i shkakton probleme propozuesit sepse i njëjti duhet që ti ndryshojë planet e tij të cilat i ka planifikuar më herët. Gjithashtu kërkoi nga gjykata që vend pranim-dorëzimi i fëmijëve të jetë oborri i Qendrës Tregtare "A" në Sh. të M., (pasiqë propozuesi aty e ka shtëpinë) ndërsa për orën propozoi që të jetë ora 10 por mund të jetë edhe ndonjë orë tjetër, kurse për dorëzimin e fëmijës nga e paditura mund të jetë një autolarje e cila gjendet afër shtëpisë së propozuesës në Z. Në fjalën përfundimtare deklaroi se shpenzimet e procedurës nuk i kërkon dhe se hjek dorë nga e drejta në ankesë. Ndërsa, propozuesi deklaroi se e përkrah në tërësi fjalën e të autorizuarit të tij.

I autorizuari i propozueses në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: nuk e kundërshton padinë apo kërkesëpadinë si të tillë dhe i propozon gjykatës që lëndën ta trajtoj si propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës, ndërsa sa i përket kontaktit të propozueses me fëmijët i propozon gjykatës që ky kontakt të mbahet dy herë në muaj dhe atë tre orë në zyret e Qendrës për Punë Sociale në M. I njëjti deklaroi se shpenzimet e procedurës nuk i kërkon dhe së hjek dorë nga e drejta në ankesë.

Në procedurën e provave gjykata administroi këto prova: certifikata e martesës me nr. rendor ... me nr. referencës dt. së lëshimit ..., certifikata e lindjes lëshuar në emër të fëmiut E. Th. e dt. së lëshimit ..., ekstrakti i gjendjes civile lëshuar në emër të S. Th. e dt. së lëshimit ..., kopja e letërnjoftimit e Propozuesit, kopja e letërnjoftimit e Propozuesës, raporti i Qendrës për Punë Sociale i dt...

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku dhe nga të njëjtat vërtetoi këto fakte:

Nuk është kontestues fakti se propozuesit kanë lidhur martesë në mes tyre me datë: ..., këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të certifikatës së martesës.

Po ashtu nuk është kontestues fakti se nga kjo martesë palët ndërgjyqëse kanë 2 fëmijë, kjo vërtetohet në bazë të certifikatës dhe ekstraktit të gjendjes civile lëshuar në emër të fëmijëve: E.Th. dhe S. Th.

Se palët ndërgjyqëse tani propozuesit raportet e tyre i kanë të çrregulluar që prej fillimit të martesës së tyre, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të raporteve të Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë të datës:

Se palët ndërgjyqëse nuk kanë pasur mundësi apo ka qenë e pamundur të arrijnë pajtim këtë më së miri e vërteton raporti i Qendrës për Punë Sociale si dhe deklarimi i palëve se te dy palët janë të interesuar t'i japin fund martesës së tyre për shkak të çrregullimit të vazhdueshëm të raporteve bashkëshortore dhe për shkak se është bërë e padurueshme jeta në mes tyre.

Sa i përket çështjes së besimit të fëmijëve gjykata vendimin e vet e bazoi në raportin e QPS-së, pasi ky raport është i hartuar në mënyrë mjaft profesionale dhe se besimi i fëmijëve propozuesit nuk është në kundërshtim me interesin e fëmijëve, përkundrazi për shkak të lidhjes emocionale të fëmijëve me propozuesin interesi i fëmijëve është që të rriten pranë babait.

Sa i përket kontaktit të prindit të cilit nuk i janë besuar fëmijët, gjykata vendosi që kontaktet të jenë dy herë në muaj dhe atë të mërkurën e parë dhe të tretë të çdo muaji dhe atë nga ora ... deri në ora ... në Qendrën për Punë Sociale në Mitrovicë pasi që për këtë gjë të autorizuarët e palëve ndërgjyqëse u pajtuan.

Sa i përket të drejtës materiale në lidhje me pikën e parë të aktgjykimit gjykata vendimin e vet e bazoi në nenet: 68 dhe 69 ku parashihet procedura e shkurorëzimit dhe shkaqet e shkurorëzimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenet: 68, 69, 84, 143, 144 dhe 145 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata vendimin e mori konform nenit 450 të LPK-së.

Aktgjykimi bazohet në nenin 143, par.1 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.602/2017 të dt.13.04.2017

KRYETARI I KOLEGJIT- GJYQTARI
Faton Ademi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Ky aktgjykim bëhet i plotëfuqishëm ditën e nxjerrjes me datë: 13.04.2017, pasi që në seancë palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.